

KOMENTET E KRYETARIT TË PREZENCËS NË CEREMONINË E HAPJES SË TË FESTIVALIT TË 6-TË TË FILMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

25 Shtator 2011

“Kam kënaqësinë të ndodhem këtu sot për të marrë pjesë në hapjen e Festivalit të 6-të të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Prezenca e OSBE-së i përfshin çështjet kryesore të të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor në mandatin e saj. Një vit më parë i thashë disa fjalë në ceremoninë e hapjes të këtij festivali. Një vit më pas, mendoj se mbeten ende shumë gjëra për t’u thënë për të drejtat e njeriut.

Evropianët vazhdojnë t’i kushtojnë një vëmendje të veçantë çështjes së të drejtave të njeriut qysh prej shekullit XVIII, kur edhe filluan fushatat e para për vendosjen e tyre. Qysh nga koha kur filozofët Immanuel Kant dhe Jean-Jacques Rousseau nisën t’u dërgonin një mesazh të qartë mbretërve, duke bërë thirrje për më shumë të drejta për geniet njerëzore, duke filluar nga liria e duke vazhduar me barazinë, respektin e ndërsjellë dhe tolerancën. Qysh prej asaj kohe, përpjekjet për ta bërë të detyrueshëm respektimin e të drejtave të njeriut nuk kanë reshtur dhe as janë ndërprerë për ndonjë çast.

Megjithëse sot shumica e shoqërive janë demokratike, është megjithatë e nevojshme që të drejtat e njeriut të monitorohen vazhdimisht dhe me shumë kujdes. Dhe kjo do filluar që nga familja, që nga lagjja ku ne jetojmë dhe që nga respekti për njëri-tjetrin, duke mos qenë diçka që u delegohet vetëm qeverive. Dhe unë besoj se filmat që do të shfaqen në këtë Festival do të japin një mesazh shumë të qartë në këtë drejtim, një mesazh që duhet dëgjuar nga të gjithë.”

Informacion shtesë: Festivali i 6-të të Filmit për të Drejtat e Njeriut u sponsorizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.